

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 201 Prot.

Tiranë, më 13.02 2017

VENDIM Nr. 21, datë 09.02.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2 të datës 09.02.2017, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren të *gërmimit të kryer pa leje, nga një individ i palicencuar në kuadër të një ndërtimi pa leje që ai kërkonte të kryejë*, realizuar nga DRKK Durrës dhe Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

VENDOSI:

1. DRKK Durrës të kryejë dokumentimin e strukturave të gjetura, të cilat kanë dalë në dukje nga gërmimi i kryer pa leje, nga një individ i palicencuar, në kuadër të një ndërtimi pa leje që ai kërkonte të kryejë.
2. Të kryhet sistemimi i territorit në kuotën e zonës ekzistuese përreth.
3. Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës të marrë masa për zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar).
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTRE



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO